

Thirrja për aplikim: “Call for Small Projects to mainstream Nature-based Solutions in the Mediterranean”

Synimi i Thirrjes

Mediterranean Biodiversity Consortium (MBC) ka shpallur një thirrje për projekte të vogla për të forcuar mbrojtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së njerëzve nëpërmjet Zgjidhjeve të bazuara në Natyrë (NbS). Kjo iniciativë synon të adresojë sfidat ekologjike dhe socio-ekonomike në rajonin e Mesdheut, duke përfshirë zbatimin e zgjidhjeve të inovative dhe të riprodhueshme për rritjen e qëndrueshmërisë sociale dhe mjedisore.

Kush mund të aplikojë

Aplikimet janë të hapura për **Organizatet e Shoqërisë Civile (CSO) vendore** që veprojnë në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit në një nga vendet partnere të projektit RESCOM: Shqipëri, Itali, Mali i Zi, Marok, Tunizi dhe Turqi. Aplikimet do të pranohen nga organizatat që kanë status ligjor, kanë përvojë në ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e projekteve dhe që janë të afta të paraqesin dokumentacion financiar dhe aktivitete të realizuara gjatë dy viteve të fundit. Projekte të vogla duhet të udhëhiqen dhe menaxhohen nga organizatat si aplikues kryesor, por projektet mund të përfshijnë edhe **partnerë si entitetet publike dhe private**. Çdo organizatë aplikuese mund të paraqesë vetëm një projekt propozim.

Fushat dhe tipet e aktiviteteve të pranueshme

Aktivitetet e pranueshme përfshijnë të gjitha aktivitetet e nevojshme për zbatimin operacional të NbS, duke përdorur një proces pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës, duke garantuar përfshirjen e popullatës, në veçanti të grave dhe të rinjve.

Aktivitetet mund të përfshijnë:

- çdo studim përpara punimeve, me kusht që ato të mos jenë thelbi i projektit;
- punë për zbatimin e NbS (veprimet në terren të nevojshme për mbrojtjen ose restaurimin e ekosistemeve);
- konsultime, komunikime dhe aktivitete ndërgjegjësuese në lidhje me projektin;
- zhvillimi dhe inicimi i masave të monitorimit ekologjik (protokollet e monitorimit, pajisjet e monitorimit, etj.);
- çdo aktivitet tjetër që kontribuon në suksesin e projektit.

Aktivitetet që gjenerojnë të ardhura të lidhura me zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe biodiversitetit janë gjithashtu të pranueshme, me kusht që të vendoset një protokoll rigoroz monitorimi për përfitimet socio-ekonomike dhe ekologjike. Shkëmbimi i përvojës ose trajnimi merren parasysh nëse zbatimi i menjëhershëm i njohurive të fituara është planifikuar gjatë kornizës kohore të projektit.

Aktivitetet e mëposhtme nuk janë të pranueshme për financim:

- projekte që fokusohen kryesisht në seminare dhe sesione trajnimi;
- aktivitetet e përsëritura dhe kostot e funksionimit të organizatës;
- projektet zhvillimore të cilat objektivi kryesor nuk është ruajtja e natyrës;

- aktivitetet e mikro-kredive;
- blerja e tokës;
- fushatat avokuese që nuk lidhen me veprimet e ruajtjes në terren.

Kohëzgjatja dhe fillimi i projekteve

Projektet e përzgjedhura do të fillojnë jo më vonë se në maj-qershor 2025 dhe do të zgjasin 12–18 muaj. Veprimtaritë duhet të përfundojnë dhe shpenzimet të jenë kryer deri në nëntor 2026.

Buxheti i thirrjes dhe për projekt

MBC do të financojë një projekt për secilin vend pjesëmarrës, me një grant prej **20,000 EUR** për projekt. Financimi mbulon deri në **90%** të buxhetit të përgjithshëm të projektit, ndërsa **10%** të mbetur duhet të sigurohet si bashkëfinancim nga aplikanti ose partnerë të tjerë financiarë si in-kind ose me pagesë në cash.

Kostot e pranueshme

Kostot e pranueshme përfshijnë shpenzimet për zbatimin operativ të NbS, stafin e organizatës (deri në **40%** të buxhetit të kërkuar), shpenzimet materiale dhe administrative, si dhe ato të monitorimit dhe mbikëqyrjes. Kostot strukturore dhe të përgjithshme janë të pranueshme deri në **10%** të kostove direkte të projektit.

Si bëhet aplikimi

Aplikimi zhvillohet në dy faza:

1. **Faza I:** Aplikimet e fazës së parë duhet të përmbajnë Formularin e Shkurtër të Aplikimit të plotësuar në frëngjisht ose në anglisht, si dhe statutet ligjore të shoqatës aplikuese dhe duhet të dorëzohen deri më **8 dhjetor në orën 23:59 CET** në adresën e emailit: apply@medconsortium.org, duke shtuar në cc: **Yaprak Arda**, përgjegjëse e IUCN-Med për këtë Thirrje (Yaprak.Arda@iucn.org) dhe **Marion Douchin**, koordinatore e projektit nga RESCOM (douchin@tourduvalat.org).
2. **Faza II:** Aplikantët e përzgjedhur do të ftohen të dorëzojnë Formularin e plotë të aplikimit deri më **30 mars 2025**, bashkë me një letër mbështetjeje nga autoritetet publike përkatëse.

Çdo pyetje në lidhje me Thirrjen për Projekte të Vogla mund të dërgohet në të njëjtat adresa emaili përpara datës **30 nëntor**.

Linku i thirrjes:

<https://www.medconsortium.org/2024/10/call-for-small-projects-to-mainstream-nature-based-solutions-in-the-mediterranean>